VENDIM
Nr. 22, datë 18.2.2013

MBI KËRKESËN PËR MIRATIM TË SKEDULIMIT TË PAGESAVE TË CEZ SHPËRNDARJE SHA (NË ADMINISTRIM TË PËRKOHSHËM)

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, vendimit nr. 5, datë 21.1.2013 "Për vendosjen e shoqërisë "CEZ shpërndarje" sh.a., në administrim të përkohshëm dhe emërimin e administratorit të shoqërisë "CEZ shpërndarje" sh.a., në zbatim të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 4, datë 21 janar 2013 "Për heqjen e licencave për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe aktivitetit të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike të shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a., rregullores "Për procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij", miratuar me vendimin nr. 1, datë 10.1.2013, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 18.2.2013, pasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike të ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e skedulimit të pagesave të "CEZ Shpërndarje" (bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë "CEZ Shpërndarje" për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani